

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI JURIDIK

PROGRAMI: KONTRATA DHE E DREJTA KOMERCIALE



PUNIM DIPLOME

**SHPËRBLIMI I DËMIT PËR SHKAK TË INVALIDITETIT NGA
POLICA E SIGURIMIT TË AUTOPËRGJEGJËSISË**

Mentori:

Prof. Dr. Rustem Qehaja

Kandidatja:

Gentiana Morina

Prishtinë, 2024

ABSTRAKT

Ky hulumtim synon të analizojë shpërblimin e dëmit jo material për shkak të invaliditetit nga polisa e sigurimit të autopërgjegjesisë në Republikën e Kosovës. Qëllimi i këtij studimi është të kuptojmë në thellësi konceptin e dëmit jo material, përfshirë aspektet emocionale dhe psikologjike të invaliditetit, si dhe të vlerësojmë praktikën gjyqësore dhe kornizën ligjore për shpërblimin e këtij lloji të dëmit. Duke u bazuar në analizën e ligjeve aktuale dhe praktikën gjyqësore, përfshirë udhëzimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, identifikojmë kriteret dhe procedurat për caktimin dhe lartësinë e shpërblimit të dëmit jo material për invaliditet. Rekomandimet e këtij studimi përfshijnë rishikimin e ligjit për sigurimet, përdorimin e ekspertizave të specializuara, inkurajimin e bashkëpunimit mes palëve të interesuara, investimin në trajnime si dhe monitorimin e vazhdueshëm të praktikës gjyqësore dhe ndryshimeve ligjore për të siguruar një trajtim të drejtë të personave të dëmtuar. Kërkimi i saktësisë dhe drejtësisë në shpërblimin e dëmit jo material për invaliditet është shumë i rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të dëmtuar në aksidente rrugore në Kosovë.

Fjalët kyçe: *Invaliditet, Polisë Sigurimi, Autopërgjegjësi, Kompensim.*